



Në bazë të Nenit 58 dhe 68, Pika 1, të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të datës 04 qershor 2008 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28, të datës 04 qershor 2008") dhe Nenit 51, Paragrafi 1, Pika 1.1 dhe Nenin 91 të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, l. Nr. 01-016/01-413431, të datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës së Pejës, me datë 20 maj 2025, bënë këtë:

NJOFTIM TAKIM PUBLIK ME QYTETARË

Ju informojmë se ditën e hënë, më datë **22 dhjetor 2025**, duke filluar nga ora **12:00**, në ambientet e **Sallës së Kuvendit Komunal të Pejës**, do të mbahet një takim i hapur me qytetarët.

Në këtë takim, të gjithë të interesuarit do të kenë mundësinë të informohen drejtpërdrejt nga **Kryetari i Komunës** dhe **Drejtorët e Drejtorive** të **Komunës së Pejës** për të gjitha çështjet që janë në kompetencë të pushtetit lokal. Ky është një rast i shkëlqyer për të diskutuar dhe për të marrë informacione të hollësishme për çdo çështje që ju shqetëson apo për të cilën keni interesim.

- **PUNËN E KOMUNËS;**
- **PRIORITETET E KOMUNËS;**
- **INFRASTRUKTURA RRUGORE;**
- **REGJISTRIMI I BIZNESEVE;**
- **SITUATA POLITIKE E SIGURISË;**
- **INTEGRIMET;**
- **INFRASTRUKTURA KOMUNALE;**
- **SHËRBIMET ADMINISTRATIVE KOMUNALE;**
- **PLANIFIKIMI URBAN I QYTETIT;**
- **NDËRTIMET PA LEJE;**
- **TAKSAT DHE TATIMI NË PRONË;**
- **BUXHETI;**

Ky takim mbahet në përputhje me detyrimet që dalin nga Neni 68, Pika 1 e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Neni 27, Pika 1 e Statutit të Komunës së Pejës.

Rëndësi të posaçme në këto takime ka pjesëmarrja aktive e qytetarëve me ide dhe sugjerime për avancimin e punëve të institucioneve komunale. Prania juaj dhe kontributi juaj janë thelbësore për përmirësimin e shërbimeve dhe funksionimit të institucioneve lokale.

Jeni të mirëpritur të merrni pjesë dhe të shfrytëzoni këtë mundësi për të kontribuar në përmirësimin e komunitetit tonë dhe për të ngritur zërin tuaj në lidhje me çështjet e rëndësishme për ju.

Gazmend MUHAXHERI

Kryetar